



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LIGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 25 maj 2011
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENSHME, SIGURI DHE
MBIKQYRJËN E FORCËS TË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Fatmir Xhelili, Goran Marinković, dhe Vjollca Krasniqi anëtarë të komisionit.

Munguan: Ganimete Musliu, Anton Quni, Ibrahim Makolli dhe Rasim Demiri - anëtarë të komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj dhe Haxhi Xhemajli.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë **06.05.2011**
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për përdorim civil të eksplozivëve
4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të dhënave personale
5. Raport nga vizita në Bruksel
6. Të ndryshme

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.05.2011

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 06.05.2011, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për përdorim civil të eksplozivëve

Kryetari- Sot e kemi për shqyrtim në parim Projektligjin për përdorim civil të eksplozivëve, mendoj se i plotëson kriteret e përgjithshme dhe si komision funksional duhet ta procedojmë për miratim në parim, po ashtu ta caktojmë grupin e punës për punë të mëtutjeshme.

Goran Marinković – Unë e kam lexuar këtë projektligj dhe i kam disa vërejtje. Në aspektin e drejtshkrimit ky projektligj është dobët i hartuar, po ashtu disa nene janë të pa qarta për mua. Po e marr një shembull, te neni 2 paragrafi 1 numërohet transporti dhe bartja e eksplozivëve por jo edhe e fishekzjarrëve, ndërsa nenet tjera kanë të bëjnë edhe me fishekzjarrët. Pastaj në nenin 5 dhe 6 nuk e kamë të qartë çka do të thotë regjistri kombëtar.

Kryetari- Gjatë punës së grupit mendoj se do të diskutohen këto çështje. Ju mund ti paraqitni vërejtjet e juaja çoftë në komision çoftë përmes grupit tuaj parlamentar.

Fatmir Xhelili- Ky projektligj është i konceptuar mirë, pra rregullon transportin, importin dhe eksportin, ruajtjen dhe mbikëqyrjen e materieve eksplozive dhe materieve tjera piroteknike. Ky projektligj i ka munguar shtetit tonë dhe është i hartuar sipas direktivave të BE-së. Pra mendoj që projektligji i plotëson të gjitha kriteret për miratim në parim.

Anëtarët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e miratuan në parim Projektligjin për përdorim civil të eksplozivëve dhe u caktua grupi punues në këtë përbërje: - Anton Quni referues, Goran Marinković dhe Fatmir Xhelili.

4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të dhënave personale

Kryetari- Si komision na ka ardhur për shqyrtim Propozim–vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të dhënave personale. Mu më ka ardhur vërejtje nga mekanizmat ndërkombëtar, në lidhje me dy anëtar, fjala është për z.Ramadan Qehaja për shkak të moshës së tij dhe z.Mentor Hoxha, i cili nuk i ka ende 3 vite përvojë pune dhe se ka diplomuar sivjet. Kjo është një çështje e ndjeshme dhe nëse e njihni ndonjërin nga kandidatët ju mund ti jepni komentet e juaja. Por mendoj që mbi të gjitha ne duhet të bazohemi në Ligj.

Rexhep Selimi- Nëse flasim veç e veç për secilin kandidat, atëherë unë dua ta jap përkrahjen time për kryesuesin z.Ruzhdi Jashari, për të cilin mendoj se është adekuat për këtë pozitë. Ndërsa sa i përket z.Ramadan Qehaja ju kisha lutë që si komision të kemi kujdes ndaj personalitetit të tij, pra të japim arsyen apo bazën ligjore për të cilën e kemi vu në fokus emrin e tij dhe jo ta fyejmë personalitetin e tij. Sa i përket z.Mentor Hoxha, edhe unë pajtohem me Ju kryetar.

Fatmir Xhelili- Unë pajtohem me Ju që të zbatohet Ligji sa i përket zgjedhjes së anëtarëve të kësaj Agjencie. Pajtohem që të aplikohet kriteri i moshës, edhe përkundër aftësive dhe përvojës së z.Ramadan Qehaja. Sa i përket z.Mentor Hoxha, unë nuk e di cilin kriter nuk e plotëson, mirëpo e njoh personalisht. Z.Hoxha e ka udhëheq dhe mendoj se ende e udhëheq Qendrën e Situatave dhe gjatë kësaj pune ka ndjek trajnime të avancuara në SHBA dhe Evropë, pikërisht për menaxhim, politika të sigurisë, për grumbullimin dhe ruajtjen e të dhënave. Andaj njohurit e tij në teknologjinë informative e bëjnë person adekuat për pozitën në fjalë. Por kisha kërkuar nga zyra ligjore e Kuvendit, të japin vlerësimin e tyre për plotësimin ose mosplotësimin e kriterëve.

Goran Marinković- Unë nuk e njohë asnjërin nga kandidatët, por gjithashtu mendoj që duhet të bazohemi në Ligj. Pajtohem që t'ia japim përkrahjen tonë z.Ruzhdi Jashari, pasi që shumica nga Ju e njihni dhe e vlerësoni si adekuat. Sa i përket z.Ramadan Qehaja, pajtohem me z.Slimi, që të kemi kujdes të mos e lëndojmë personalitetin e tij. Dy kandidatët e tjerë z.Bekim Demiri dhe z.Aleksander Spasić, unë nuk i njoh, por pasi që Qeveria i ka propozuar me siguri që i plotësojnë edhe kriteret. Për z.Mentor Hoxha, unë pajtohem me z.Xhelili që përvoja e punës dhe fakti pse ka diplomuar sivjet, nuk duhet të jenë pengesë nëse kandidati është i përshtatshëm për atë pozitë, sepse mendoj se njerëzit që e kanë propozuar e njohin dhe e kanë vlerësuar si adekuat.

Kryetari- me Ligj është e caktuar përvoja e punës 3 vjeçare dhe ne duhet të bazohemi në Ligj. Mirëpo pasi që na duhet kohë ta bëjmë një vlerësim më të hollësishëm, unë propozoj që këtë çështje ta shtymë për takimin e radhës.

Anëtarët e komisionit u pajtuan që shqyrtimi i Propozim–vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të dhënave personale, të shtyhet për takimin e radhës.

5. Raport nga vizita në Bruksel

Kryetari- Ju e keni marr një raport njoftues për vizitën që e kemi realizuar në Bruksel, mendoj që ka qenë një vizitë shume e nevojshme për marrjen e njohurive të reja për ne. A ka dikush diçka të shtoj në lidhje me raportin.

Rexhep Selimi- Unë mendoj se ndoshta do të duhej që ky raport të jetë më përmbajtjesor, pra të përfshihet në hollësi agjenda e takimeve që kemi pasur. Ndërsa një gjë që ndoshta s' duhet të jetë pjesë e raportit por që duhet ta theksojmë është niveli i pakënaqshëm i Ambasadës tonë në Bruksel. Ne kemi qenë një nivel i lartë i delegacionit të Kosovës dhe niveli i komunikimit të Ambasadës tonë atje me këtë delegacion ishte zero. Pra ta bëjmë adresimin e nivelit të Ambasadës në adresën e duhur, sepse mendoj se kjo nuk do të ishte gjë e keqe, përkundrazi do të ishte më shumë ndihmë për përmirësimin e nivelit të Ambasadës tonë.

Kryetari- Faleminderit z.Selimi, ne mund t'ia bashkëngjisim edhe agjendën raportit, edhe pse ky raport, është më shumë si njoftim për kryesin, rreth vizitës tonë në Bruksel.

6. Të ndryshme

Kryetari- Unë dua të ju njoftoj për një takim që e kemi me komisionin homolog të Çekisë, me datë 1 Qershor, kisha dashur që të gjithë të jeni të pranishëm në mënyrë që ti shkëmbejmë përvojat e përbashkëta. Po ashtu sot në ora 12 e kemi një takim në Qendrën e trajnimeve të FSK-së në Ferizaj, kush ka interesim mundet të merr pjesë.

Pasi që nuk kishte çështje tjera për diskutim, kryetari i komisionit e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoj në ora: 11:10

E hartoi:

Njësia mbështetëse e komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi